

VENDIM
Nr.610, datë 11.6.2009

PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT SPECIAL TË KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi i kompensimit të pronave, i krijuar me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, trajtohet si fond special dhe administrohet në një llogari të veçantë, në thesarin e Bankës së Shqipërisë.

2. Administrimi i fondit të kompensimit të pronave bëhet nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

3. Burimet e krijimit të fondit të kompensimit të pronave janë:

a) transfertat e Buxhetit të Shtetit për kompensimin e ish-pronarëve;

b) të ardhurat e realizuara nga shitja me ankand e pasurive shtetërore, për të cilat nuk ka vendim të dhënë nga komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave (sipas përcaktimit në shkronjat “a” e “b” të pikës 27 të kapitullit III të vendimit nr.1638, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave);

c) të ardhurat e arkëtuara nga transferimi i pronësisë së parcelës ndërtimore, në bazë të përcaktimit të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar;

ç) të ardhura nga donatorë të ndryshëm.

4. Fondi i kompensimit të pronave përdoret për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, që kanë fituar të drejtën e kompensimit financiar, në kushtet kur kthimi fizik i pronës së tyre ka qenë i pamundur.

5. Burimet, që përbëjnë fondin e kompensimit të pronave, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të arkëtohen dhe administrohen, sipas natyrës së tyre, nëpërmjet sistemit të thesarit, në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Financave, të nxjerrë në zbatim të këtij vendimi.

6. Për pronarët e shpronësuar nga procesi i legalizimit të ndërtimeve informale, shuma e pagesës për secilin përfitues përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Dhënia e pagesës bëhet me këste të barabarta dhe të shtrira në kohë, në varësi të të ardhurave të arkëtuara nga pronat e legalizuara.

7. Për pronarët e tjerë, të cilët kanë fituar të drejtën e kompensimit monetar nga komisioni i kthimit të pronave, shuma e pagesës dhe mënyra e dhënies së saj bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave.

8. Gjendja e mjeteve monetare, të papërdorura në fund të vitit buxhetor, në llogarinë e veçantë, në Bankën e Shqipërisë, mbartet për llogari të vitit të ardhshëm.

9. Llogaritë e fondit special të kompensimit të pronave paraqiten në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, së bashku me buxhetin faktik.

10. Ngarkohet Ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimit përkatës, në zbatim të këtij vendimi.

11. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe ALUIZNI për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha